



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

VENDIM

Nr 45, datë 28.10.2015

Për marrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec dhe në zbatim të ligjit nr 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 10, pika 3, nën pika I, gërma g, i ndryshuar, ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 12, neni, 13, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" neni 58, Këshilli i Bashkisë

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec, për Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, sipas ligjit, për marrjen e nismës së hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Planifikimit të Territorit për të gjithë territorin administrativ që mbulon Bashkia Pogradec. Mbështetur në ligjin, nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 12, neni, 13, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" neni 58, dokumentacioni duhet të përmbajë:

1. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Pogradec për marrjen e nismës për hartimin e PPV.
2. Analizën e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartimin dhe rishqyrtimin të dokumentit të planifikimit.
3. Dokumentat që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas ligjit
4. Kufijtë e territorit të Bashkisë
5. Planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor
6. Strategjinë e miratimit të tij: në një apo dy ndalesa;
7. Listën e dokumentave përbërëse të PPV-së
8. Ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PPV.



-2-

9. Forumi Këshillimor i Planit

10. Përcaktimet për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike me afatet përkatëse.

11. Buxheti për hartimin e PPV-së.

12. Vendimi për pezullimin e zhvillimit për të gjithë ose një pjesë të territorit shoqëruar me hartën përkatëse.

KRYETARE
Natalja VELO



Faqe 2 nga 2

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku" Lagja: Nr.2

Tel: +355 (83) 22222, +355 (83) 22465 Fax: +355 (83) 22441, +355 (83) 22424

E-mail: zyrainfo@gmail.com, bashkiapogradec@gmail.com

53